

**LEDIONA LUMI**

**TIPARE TË GJUHËS SË POLITIKËS BASHKËKOHORE**

**Gënjeshtra në gjuhën e politikës si sfond njerëzor**

Gënjeshtra është në botë. Ajo është brenda nesh dhe rreth nesh. Nuk mund t'i mbyllësh sytë para saj. "Omnis homo mendax", - thotë një varg psalmi (115, II) dhe ne mund ta përkthejmë: "njeriu është një qenie e gjallë e cila di të gënjejë. "Në të vërtetë njerëzit gënjejnë, në të shumtën e rasteve me gjuhën; ata thonë gënjeshtrën dhe e kthejnë gunën nga fryn era dhe ajo nuk mund të pengojë që "flamujt e gënjeshtrës" (Goethe) të shpalosen kaq shpesh. Ky mund të jetë vërtet një përkufizim mizantropik, por ai është i pakundërshtueshëm. Mizantropi i Moliere merr nga ai të drejtën për të urreyer të gjithë racën njerëzore. Agustini si i pari person që ka parë "aspektin gjuhësor" të gënjeshtrës, u kujton njerëzve se gjuha nuk është dhënë atyre me qëllim që të mashtrojnë njëri-tjetrin, por me qëllim që ata t'i rrëfejnë njëri-tjetrit idetë dhe mendimet e tyre. Kush e përdor pra gjuhën për të mashtruar, e shpërdoron gjuhën dhe ky është mëkat. Fjalët e gjuhës janë shenja të shpirtit; është kundër natyrës së tyre dhe kundër shpirtit për ta vendosur atë në shërbim të gënjeshtrës. Gjuha duhet të shfaqë idetë dhe mendimet, dhe jo t'i fshehë ato. Funksionimi i gjuhës për shenjat është në rrezik. Ai është arritja më elementare, por pikërisht për këtë arsye më themelore e gjuhës. Gënjeshtra është prishja (zvetërimi) i gjuhës. Edhe nëse jo të gjithë njerëzit i fshehin idetë dhe mendimet e tyre me gjuhën, tek politikanët dhe diplomatët, gënjeshtra është pjesë e profesionit. Ajo është art. Heiko e pranon idenë dhe e hap atë si një erashkë: "Ka profesione të tëra, nga të cilat populli që në fillim supozon, që ato do të detyronin përfaqësuesit e tyre të gënjenin, për shembull teologët, politikanët, laviret, diplomatët, poetët, avokatët, artistët, aktorët, falsifikuesit e kartëmonedhave, komisionerët e bursave, prodhuesit e produkteve ushqimore, gjyqtarët, mjekët, zhigolotë (meshkujt që pëlqehen nga femrat), gjeneralët, kuzhinierët, tregtarët e verërave. Për rezervime, punë gjysmake dhe gënjeshtra është një gjuhë e mrekullueshme; ajo është një gjuhë e pabesë (...)" Por, mund të ishte, që gjuha nuk është aspak veshje e mendimit, siç ka gjykuar njëherë Wittgenstein, por përkundrazi veshje ndryshe e tij. Një dyshim të tillë e hasim shpesh. Kur përpara shumë vitesh shkencëtarët e të gjitha disiplinave u bashkuan për një hulumtim shkencor kolektiv të fenomenit të gënjeshtrës, edhe gjuhëtari Frederic Kainz u ftua për të bërë një artikull mbi dukuritë e gënjeshtrës në botën e gjuhës. Duke ndjekur Augustinin, ai konstaton në fillim, që të gjitha gënjeshtrat janë thënie gjuhësore dhe si pasojë bëjnë pjesë në fushën e madhe të gjuhës. Kainz kontrollon pastaj gjuhën për gënjeshtra dhe gjen nga këto, kaq shumë, sa që lexuesi duhet të frikësohet shumë. Me të njëjtën të drejtë siç thuhet nga gjuha, ajo mendokërka dhe vjeshërokërka për ne, lejohet gjithashtu sipas mendimit të F.

Kainz, që ajo gënjekërka për ne. Ai krijon për këtë shprehjen “joshje gjuhësore”. Ai mendon se të menduarit tonë lëviz në rrugë gjuhësore, dhe që gënjeshttrat e gjuhës si pasojë detyrojnë edhe të menduarit tonë për të gënjyer. Por, gënjeshttrat gjuhësore janë nëse i marrim gjërat me shumë kujdes, shumica e figurave retorike si eufemizmat, hiperbolat, elipset, shumëkuptimshmëritë, format dhe formulat e mirësjelljes, emfazat, ironia, fjalët- tabu, antropomorfizmat etj. Të vërtetës i mbetet në gjuhë, vetëm një rrugicë e ngushtë. Kjo është, siç mund të merret me mend, fjalja dëftore e pastër, të cilën e do logjika. Ja pse njerëzit duhet t’i kuptojnë “ndërrimet e rrobave” të gjuhës shumë mirë. Është interesante që ne si folës të një gjuhë sinqerisht e dimë se luajmë për ditë lojë e krijimit të hipotezave dhe të verifikimit ose falsifikimit të tyre, të njëjtën lojë, për rregullat e të cilës është zotuar shkenca. Gjuha është pikërisht sipas strukturës së saj një shkencë parashkencore, pasi, me gjuhë ne zotohemi, premtojmë dhe “hedhim hi syve”.

#### **Gjuha e politikës si një “lloj i veçantë gjuhe”**

Në të gjitha fushat njerëzit komunikojnë me njeri-tjetrin, gjuha merr rolin më të rëndësishëm për t’i shprehur mendimet tona. Ajo është mjeti më i rëndësishëm i marrëveshjeve njerëzore e prandaj elementi themelor i të gjitha marrëdhënieve sociale<sup>1</sup>.

1. Edhe në fushën e politikës gjuha zë një vend qendror për politikanët. Gjuha i ofron politikës një mjet për të informuar, udhëzuar, për të bindur dhe për të indoktrinuar. Natyrisht vendin e parë në komunikimin politik e zë përmbajtja, por ndikimi i disa parullave, formulat për t’iu drejtuar dikujt ose papërcaktueshmëria e disa shprehjeve nuk duhen nënvlerësuar përse i përket fuqisë vepruese të tyre. Sipas Martin Greiffenhagen-it në një demokraci si të asaj të Republikës Federale Gjermane, politikë do të thotë veçanërisht një argumentim publik dhe një debat parlamentar<sup>2</sup>.

2. Edhe këtu na shfaqet se ç’domethënie ka në veçanti gjuha e folur për politikanët dhe procesin e të mbrujturit të mendimeve në përgjithësi. Qysh prej kohës së republikës greke dhe romake, politikanët studionin për këtë arsye logjikën, retorikën, dialektikën dhe hermeneutikën. Qëllimi i këtij punimi do të jetë fillimisht të ndërmerret një përpjekje për të përkufizuar gjuhën e politikës. Çfarë nënkupton gjuha politike dhe çfarë destinacionesh të ndryshme na paraqesin literaturat përkatëse? Në pikat vijuese do të shqyrtohen funksionet e ndryshme të gjuhës politike, duke iu përkushtuar në radhë të parë gjuhës politike, në funksionin e saj të veprimit gjuhësor dhe funksionit mendim-mbrujtës si dhe mendim-ndryshues. Si mund të jetë gjuha në politikë njëkohësisht edhe një veprim? Çfarë synimesh mund të ndjekë gjuha në politikë dhe ç’rrjedh nga kjo për ndërtimin e saj? Si pikë rëndësie në këtë punim do të merremi me veçantitë e gjuhës politike. Çfarë roli luan parulla politike? A ka leksema specifike që përdoren si leksik në

<sup>1</sup> W. Bergdorf, *Fjalët si armë. Gjuha si instrument i politikës*, Stuttgart, Shtëpia botuese Bon, 1979, f. 8.

<sup>2</sup> M. Greiffenhagen, (ed): *Lufta për fjalët? Termet politikë në Meinungsstreit*, Munchen, Shtëpia botuese Carl Hanser Verlag, 1980, f. 10.

## Tipare të gjuhës së politikës bashkëkohore

---

radhë të parë në rrethin politik? Pse përdorin politikanët në fjalimet e tyre figura retorike dhe terma të papërcaktuara? Në fund të punimit tonë do t'i përmbledhim rezultatet dhe do ta shqyrtojmë gjuhën e politikës për sa i përket veçantive të saj.

Se çfarë kuptimi ka termi “gjuha e politikës” ose “gjuha politike” nuk është përcaktuar as në gjuhësi përfundimisht. Në këtë kontekst duhet të merret parasysh se gjuha politike - sikur pothuajse në të gjitha fushat e tjera - lëviz brenda një korrelacioni mes veprimit individual gjuhësor dhe rregullave të detyrueshme kolektive në përdorimin e gjuhës. Ajo i referohet gjithnjë kornizës shoqërore brenda së cilës flitet ose shkruhet.<sup>3</sup> Si rezultat logjik rezulton nga një shndërrim politik ose shoqëror edhe një ndryshim gjuhësor, trajtimi i të cilit shkurtimisht do të jetë pjesë e kësaj pune. Wolfgang Bruggemann i referohet dallimit që bën gjuhësia mes gjuhës funksionale dhe gjuhës mendimore dhe e përkufizon gjuhës funksionale si: “Një gjuhë e cila shpreh probleme të pazgjidhura gjuhësore dhe pikas procese politike ose përcakton institucionet në mënyrë terminologjike.”<sup>4</sup> Në këtë punim do të ndriçohen të dyja anët e gjuhës politike. Sikurse hetohet aspekti i gjuhës funksionale mbi leksikun politik, ashtu do të diskutohet këndvështrimi i gjuhës mendimore për herë e më shumë mbi figurat retorike “ne” - në inklusive d.m.th ne-ja që i referohet simbolikisht një unë- uni të fshehur pas pasqyrës së premtimeve të parrealizuara dhe papërcaktueshmërisë së termave. Pajisur me referime të para për sa i përket funksionit të gjuhës politike, Armin Burkhardt-i e përshkruan komunikimin politik, në vend të parë si të “organizuar sipas një qëllimi final”<sup>5</sup>. Ai i referohet faktit se gjuha politike përdoret gjithmonë sipas qëndrimeve politike, rrjedhimisht, nuk e ka vetëm funksionin e prezantimit, por përmban gjithmonë edhe një karakter apelativ dhe nuk është deskriptive ose informuese. Aspekti i influencimit të dëgjuesve / lexuesve nëpërmjet një përdorimi të përcaktuar të gjuhës është i konsiderueshëm në fushën e politikës. Muller-i shton më tutje, se gjuha politike është kryesisht publike dhe një komunikim i drejtuar publikut. Ky përkufizim duket në fillim shumë kufizues, megjithatë në të rrokën edhe të gjitha llojet e teksteve politike, si programe partiake, fjalime fushatash, fjalimet e politikanëve, debatet parlamentare ose projektligje.<sup>6</sup> Ia vlen të mendohet në këtë mes se çfarë aktesh ligjërimore nuk mund të merren sipas këtij definicioni si gjuhë politike. Vetëm kontrata dhe marrëveshje të fshehta mes disa aktorëve ose letrat dhe telefonatat mes politikanëve si dhe debatet në komisionet larg nga publiku nuk do të merreshin pastaj si gjuhë politike ndonëse edhe ata hasen në fushën e politikës. Gjuha politike sipas Jozef Klein-it nuk është një shembull tipik i një gjuhë specifike. Karakteri i saj i përzier, kryqëzimi i saj me gjuhë të tjera specifike, si dhe gërshetimi i saj i gjerë me gjuhën e përditshme flasin kundër një karakterizimi të

---

<sup>3</sup> A. Dorner, *Gjuha politike- instrument dhe institucion i politikës*, B17/91, f. 3-11.

<sup>4</sup> W. Bruggeman, *Shënime mbi gjuhën politike*, Dusseldorf, 1977, f. 12.

<sup>5</sup> A. Burkhardt, *Parlamenti dhe gjuha e tij*, Shtëpia Botuese Max Niemeyer, 2003.

<sup>6</sup> U. Muller / F. Hundsnurscher, *Një analizë gjuhësore e fjalës politike*, Shtëpia Botuese Kummerle, Verlag, 1989.

tillë. Edhe Valter Dieckman nuk sheh në gjuhën politike një gjuhë veçmas specifike, por një gjuhë e cila mund të quhet në përgjithësi më shumë si një “kompleks veprimor e funksional” dhe nuk paraqet një fushë të vetën të kufizuar. Megjithatë ekziston një dallim mes gjuhës politike dhe gjuhës së përditshme. A. Naser Shrouf përmbledh përkufizimet të ndryshme shkencore për gjuhën e politikës në një përcaktim terminologjik shumë përgjithësues në vijim: “Një sërë punimesh shkencore e konsiderojnë për këtë arsye gjuhën politike si gjuhë shteti ose të gjithë atë e cila i referohet shtetit ose pushtetit shtetëror: Institucionet, funksionet dhe praktikatat e politikës.” Një përkufizim shumë të detajuar me kritere specifike formulon Klaus Watzin-i siç shihet në vijim: “Si gjuhë politike duhet të quhen të gjitha veprimet gjuhësore, me të cilat një folës/shkrues përpigjet të ushtrojë ndikim shtetëror në mburrjtjen e opinionëve në jetën publike ose brenda institucioneve politike (parlament, qeveri, administratë, gjyqësi, parti dhe organizata politike)”. Sipas kësaj, gjuha politike ndërlidhet në kuptimin më të gjerë me një grup specifik personash, nga të cilët përcillet kjo gjuhë (politikanë, nëpunës). Pyetja se çfarë vetish specifike gjuhësore duhet t’i nënrenditen gjuhës politike shkakton ende debate në shkencë.

Gjuhëtarët shqiptarë nga ana tjetër bien dakord se gjuha politike është mjeti kryesor i politikëbërjes dhe përdoret në varësi të interesave të caktuara politike e mund të jetë e qartë dhe e paqartë sipas vërtetësisë së politikanëve. Ajo është gjuha që të vret natën e të qan ditën, - shprehet një studiues kosovar, duke vënë theksin në pabesinë e saj, në forcën ekstremisht të theksuar shigjetuese e manipuluese ndaj atyre që mundohen ta frenojnë a t’i bien ndesh. Ajo është gjuha e karrikexhinjve, e kolltugofagëve, atyre të veshur me pushtet...

Shkrimtari Xhorxh Oruell thotë se armiku më i madh i qartësisë së gjuhës është mungesa e sinqeritetit. Sipas tij gjuha politike është e ndërtuar e tillë që të bëjë gënjeshtër të tingëllojnë të vërteta dhe vdekjen të respektueshme. (Orwell, “Politics and the english language”, 1946) Autorë të tjerë amerikanë R. Denton dhe G. Uduord e karakterizojnë komunikimin politik si një mënyrë e qëllimtë e dërguesit për të ndikuar mjedisin politik. Ata thonë se: “faktori themelor që e bën një komunikim ‘politik’ nuk është burimi i mesazhit, por përmbajtja dhe qëllimi i tij”. Pra, është “komunikimi i qëllimtë i politikës”, në të cilën aktualizohen jo vetëm ai verbal e ai me shkrim, por edhe prezantime vizuale si p.sh.: veshjet, simbolet (kujto simbolet, logot e PD-së, PS-së, dora që prek e shtrëngon një trëndafil rozë, forma e stërzgjatur e një D-je të madhe etj.)

“Gjuha politike mund të ndërtojë realitete politike nëpërmjet forcës së argumenteve bindës.” (M. Edelman, Universiteti i Viskonsinit). Ndërkaq edhe sociologu shqiptar Gëzim Tushe krahas mirëpranimit të idesë së mësipërme mbron edhe bindjen se janë më së shumti argumentet emocionale ato të cilat e kanë vështirësuar akoma më shumë transmetimin e mesazhit politik mes palëve. Shumëkush sot mund të thotë se propaganda është diçka që i përket të kaluarës, megjithatë literatura akademike shprehet se disa nga format e saj janë përsëritja e frazave, eufemizmi, indoktrinimi i publikut, duke thirrur kryesisht më shumë emocionet se sa intelektin. Të synosh drejt një komunikimi të qartë dhe të

drejtpërdrejtë është një utopi, pasi siç thotë edhe Orwell çdo përpjekje kundër abuzimit me gjuhën është thjesht një sentimentalizëm i vjetruar, njëlloj si të preferosh qirinjtë ndaj dritës elektrike.

Edhe një letër e palexuar, drejtuar një komisioni për peticion, është tentativë për ndikimarrje dhe duhet të vlerësohet për këtë arsye si gjuhë politike. Ky përcaktim terminologjik ka sipas mendimit tonë, dobinë e vet në literaturën përkatëse. Në përpjekjet për të përcaktuar gjuhën politike kriteret e Watzin-it ofrojnë orientim për ta qartësuar thelbin e gjuhës politike. Nën pikave që vijojnë do t'u japim prandaj si bazë definicionin e Klaus Watzin-it, si më të duhurin sipas mendimit tonë.

#### **Shërbimet e gjuhës së politikës. Gjuha politike si ndërveprim gjuhësor**

“Gjuha nuk është vetëm një instrument i politikës, por në përgjithësi kushti i mundësisë së saj. Politikani, si aktori që vepron në skenën politike, përdor gjuhën në situata të ndryshme (...). Gjuhë politike do të thotë për këtë arsye veprim politik.”<sup>7</sup> Njëri nga funksionet qenësore të gjuhës politike duhet të jetë veprimi, i cili ushtrohet përmes një akti të caktuar ligjërimit. Gjuha nuk është - siç konstaton pohimi - vetëm një mjet politik, neve na paraqitet edhe pyetja: A mund të mendohet politika, pa përdorimin e gjuhës? Një folës gjatë aktit të të folurit ndërmerr më shumë se prodhimin e strukturave fonetike, leksikore dhe gramatikore. Në një bashkëveprim me mjedisin e tij, duke përjashtuar këtu të folurit me vetveten, ai shkakton reagime të veçanta tek bashkëbiseduesit e tij, përmes fjalëve që përdor. Qartë si rrallë ndonjëherë shfaqet karakteri veprimor i gjuhës në përdorimin publik të gjuhës në politikë. Vetëm disa fjalë të formuluar në mënyrë jokorrekte mund të shkaktojnë mosmarrëveshje mes partive ose konflikte në marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve. Një fjalim i vetëm mund të mbrojë një politikan. Në mënyrë të përmblodhur: Gjuha politike mund të ketë pasoja të pandërmjetme dhe mund ta ndryshojë realitetin. Vetëm një fjalë mund të nderë gjakrat mes dy popujve e të hapë luftëra të dhimbshme për shumë vjet. Të vjen menjëherë në mend shprehja e famshme e të madhit Sami Frashëri se: “Viktimat e fjalëve (gjuhës) janë më të shumta sesa viktimat e luftës.”

#### **Funksioni i mbrutjes së mendimeve**

Si një funksion tjetër i gjuhës politike duhet të përmendet krahas karakterit të saj veprimor edhe roli i saj si mjet komunikimi, duke aktualizuar me qëllim të shoqërizimit të individit. Edukimi - si dhe edukimi politik - i jep një grupi atë që është dhe atë që duhet të jetë pronë e mirëqenë gjuhësore e të gjithëve në interes të bashkëjetesës dhe bashkëveprimit kolektiv. Në kuptimin politik duhet të mësohen mënyra të caktuara të të menduarit ose konceptime vlerash, të cilat i përbëjnë ideologjitë e ndryshme të disa mendimtarëve/filozofëve. Çdo vendim politik vjen para një procesi të ri të mbrutjes së mendimeve. Por, funksioni i të mbruturit të mendimeve në gjuhën politike është - siç tregon citati i mëparshëm i Armin

---

<sup>7</sup> G. Heiko, *Gjuha dhe përdorimi i gjuhës në politikë*, Tubigen, Vëllimi 39, 2002, f. 1.

Brukhardit- rrallëherë vetëm deskriptiv, por fillimisht i organizuar sipas një qëllimi final dhe ndjek këtë arsye për një qëllim të caktuar.

Ky koncept i fundit të çon në idenë e gjuhës si mjet marrëveshjeje dhe mosmarrëveshjeje në të njëjtën kohë. Sosyri me revolucionin e tij gjuhësor do ta shohë gjuhën si formë të veçantë që formëson mendimin, i cili për nga natyra është kaotik. Gjuha, - thoshte De Sosyri, - mund të krahasohet me një fletë letre: mendimi është njëra anë e tingulli ana tjetër. Të tillë do ta konsiderojmë edhe ne përgjatë gjithë punimit tonë gjuhën e mendimin në politikë. Caqet e gjuhës janë caqet e mendimit prandaj edhe në politikë mbretet e mirëvlerësuar ideja e Nietsches se edhe: “Aristokracia e mendjes duhet të drejtohet nga aristokracia e gjuhës”. Lidhur me kauzën tonë (fjalë kjo e dashur në politikë) ne do t’i shtonim këtij binomi edhe një të tretë “aristokracia e pushtetit” bashkangjitur me sa vijon më poshtë.

#### **Funksioni i ndryshimit të mendimeve**

Më parë u prek përciptazi rëndësia e funksionit mendim-ndryshues ose funksioni kontrollues i gjuhës politike. “Kush i emërton gjërat i sundon ato” - argumenton Martin Greiffenhagen-i dhe përmend kështu aspektin më të rëndësishëm të gjuhës politike. Çfarë detyrash vendimtare ka përdorimi i gjuhës së politikës përmes një folësi - qoftë në fjalime fushatash zgjedhore, debate parlamentare ose deklarata qeveritare? Gjuha politike duhet t’i bindë shikuesit për një qëndrim të deklaruar, të sjellë miratim dhe t’i mbështesë pikëpamjet e paraqitura. Aktori gjuhësor i politikës do të përpiqet të evokojë kognicione, emocione dhe vlerësime të veçanta tek elektorati i tij për të mësuar një veprim të caktuar politik. “Forca e gjuhës për të sajuar kuptime e bën atë një element qendror kontrollimi të politikës, i cili i lejon politikës, pa dhunë fizike ose joshje materiale, të mobilizojë masa njerëzore edhe atëherë kur pengesa morale duket se e pamundësojnë një mobilizim të tillë.” Ky citat i Andreas Dorner përshkruan në mënyrë impresionuese impaktin e gjithashtu edhe rrezikun që përmbajnë gjuha politike dhe potenciali i saj manipulues. Në qoftë se mbulohen edhe dramatizohen rreziqet përmes mjeteve retorike të eufemizmit dhe të hiperbolës bëhet për qytetarët gjithnjë e më e vështirë t’i njohin faktet e vërteta.

#### **Leksiku politik dhe veçantitë. Parullat (sloganet)**

Si pjesë e pandarë e gjuhës së politikës parulla ose fjala kyç formon një element qendror në ligjëratën politike - sidomos në reklama për konceptet dhe programet politike. Bruggemann e sheh detyrën e parullës në “ndikimin e opinionit në sistemin e të mbrujturit të mendimit (edukimi) dhe të ndryshuarit të mendimit (propaganda)”. Vetëm një shfrytëzim i tillë - në shumicën e rasteve ‘bindja e të tjerëve’ - e bën parullën një parullë të vërtetë. Në këtë mënyrë mund të ndodhë që fjalë të tilla si demokraci, përparim ose socializëm të përdoren në situata specifike si parulla (p.sh. në fushatë zgjedhore), edhe pse kanë një përdorim tjetër në gjuhën shkencore.

Autori nuk sheh në parulla vetëm gëzhoja të zbrazëta fjalësh dhe i përkufizon ato duke thënë se janë fjalë që “përdoren shpesh në argumentin publik dhe që në formën e tyre të ngjeshur shprehin ose provokojnë qëndrime politike. Parullat

shërbejnë si elemente për të influencuar. Ato janë armët kryesore të argumentimit politik, duke qenë vetë objekte të luftërave. “Me anë të këtyre shpjegimeve parullat mund t’i nënrenditen, ndër të tjerave, gjuhës politike, në të cilën mund të ndryshojnë kuptimin e tyre kundruall kuptimit që kanë pasur në fillim. Dëgjuesi percepton nga një ligjëratë me shumë parulla një sërë fjalësh, të cilat i referohen sfondit ideologjik të veçuar nga teksti, duke u tërhequr emocionalisht në grackën e tyre dhe duke përzgjedhur në moment kahun se nga do të fryjë era e tij. Përdorimi i termave, që kanë përmbajtje pozitive si parulla, është njëri nga elementet kryesore në gjuhën politike. Veçanërisht në fushatat zgjedhore përdoren për shumë fjalë parulla, sepse zgjojnë dëshirat e shikuesit. Përmbledhtazi mund të thuhet se parullat, si instrumente të rëndësishme të gjuhës politike, bashkojnë qëllime dhe vlera, përdorin në mënyrë të vetëdijshme asosacionet e dëgjuesit për t’i shfrytëzuar ato qëllimisht për një gjë të caktuar dhe arrin të prezantojnë fjalë zgjedhjeje për programe të caktuara. Nga sloganet e shqyrtuara kemi parë se krahas fjalës drejtësi të shkruar, vendosjen në mënyrë metaforike të peshores (foto) si një shenjë simbolike, pasi drejtësia ashtu si peshorja i peshon veprimet. Metafora, siç do të shohim edhe më poshtë, vepron fuqishëm edhe nëpër pankartat e sloganeve. Aktori politik përzgjedh kështu të kombinojë më së miri fjalë dhe imazhe. Kemi vërejtur se sloganet e sotme i përbashkojnë fjalë si: evropiane, së bashku, e vetmja, asistencë, lider, demokraci, votë, e vetmja rrugë, transparencë, vazhdojmë, rrjedhojë kjo e plotësimi të zgjerimit të strukturës fjalëformuese me nuanca e ngjyra të reja. Sloganet e mëparshëm ishin të thatë, fjalë të rregullta e të pangjyra me domethënie direkte e mbeteshin po të njëjtat për ideologjinë e sistemit. Edhe pse të dy kampeve të kundërt sloganet përbashkësohen bashkë edhe nga strukturat gramatikore, leksikore e semantike të tyre. Vihet në lojë edhe të-ja e lidhore e cila pas kësaj fsheh kërkim për bashkëpunim në arritjen e asaj që premtohet, simbolika e thellë e përdorimit të shkronjave kapitale, përsëritja tre apo katër herë e së njëjtës fjalë (vota për mua, votë për fëmijët tuaj, votë për komunë evropiane) si forma të manipulimit shoqëror (t’i bësh njerëzit të besojnë atë çka thua në interes të tyre duke ua hequr si me magji hallet e duke ua bërë realitetin përrallë). Fjala vazhdoj/im shpreh një pikënisje të rreme, por aspak një pikëmbërritje në funksion të plotë janë edhe pozicionet e ndryshme që zënë fjalët më me theks (para apo në fund të thënies), përdorimi i përemrave vetore, ne, ju, unë (ne –si një ngërthim fuqiplotë e një uni-unë), përdorimi i përemrave të përveçëm në të shquarën (Xhelili e vetmja rrugë për Fierin), i ndajfoljeve të vendit e të kohës, pikësimi, trajtat e shkurtra respektive të përemrave vetorë të mësipërm dhe së fundi prapa një slogani qëndron edhe një imazh i ndërtuar mbi analogjinë (si një lloj zëvendësuesi i realitetit). Ja disa shembuj: Për Vlorën evropiane; Të bëjmë Tiranën qytet evropian; Pranë jush, me ju; Ne të parët për vendlindjen; ku siç shihet dallohet një mospërfshirje e thëniesit në rastin e ju-së dhe e kundërta për ne. Gjuha i jep njeriut mundësinë që të përfshihet në një status të caktuar mbi bazën e të cilit edhe vishet me një prestigj social ose me tiparet e një network-u pa prestigj, të papërfillur, të mënjeluar...

### **Fjalori dhe marrëdhënia e politikës me të. Fjalori Institucional**

Siç përshkruhet edhe në literaturën përkatëse termat specifike politike formojnë një pjesë të madhe të gjuhës së politikës. Për ta bërë paraqitjen e sasisë dhe të strukturës politike të mundur duhet të vihen si bazë kriteret semantike dhe pragmatike. Kriteri semantik nënkupton se leksiku politik duhet të trajtohet në kuadër të sistemeve pushtetore dhe të ideologjive vendase. Burkhardt-i thotë lidhur me këtë se: “leksiku i çdo sistemi pushtetor kërkon një trajtim të veçantë.” Prandaj mundet që gjuha e nacional-socializmit të ketë shumë terma nga fusha e biologjisë, si racë ose absorbim, celulë etj., ndërsa fjalët punëtor ose eksploatim duhet t’i nënrenditen gjuhës së shtetit socialist. Krahës kriteretve semantike, leksiku politik mund të ndahet edhe sipas kriterëve pragmatike. Këtu qëndrojnë në radhë të parë simbolet në fokusin e shqyrtimeve. Nëse simbolet përdoren në një kontekst politik dhe zhvillojnë një forcë të mjaftueshme bëhen vetë politike. Shprehja demokraci - edhe në u kuptoftë si simbol ose parullë - mund të përdoret prej shteteve me kuptime të ndryshme, por një nënrenditje e kuptimit mund të bëhet vetëm pas zbatimit praktik të këtij kuptimi. Si grup të parë të leksikut të tij politik përmend Dorner fjalorin institucional. Ai mbështetet mbi termin institucional të Bernard Schafer-it, i cili e konsideron termin si një “institucion social që cakton për një kohë të vazhdueshme se çfarë duhet bërë. Duke kufizuar të vepruarit kuturu dhe arbitraritetin e sjelljeve sociale, ato terma ushtrojnë një efekt normativ dhe përcaktojnë detyra”. Sipas kësaj ai e kupton gjuhën institucionale si një gjuhë institucionesh dhe organizatash të një bashkësie, p.sh., bundestagu, parlamenti, fraksioni etj. Përveç kësaj, në këto institucione trazohen role dhe detyra të caktuara në politikë (p.sh. kancelari, mandat, etj.) Në këtë mënyrë edhe veprimet dhe proceset politike i përkasin fjalorit institucional, si p.sh. zgjedhjet e bundestagut, fushatë zgjedhore, lexim ligjor. Domethënë autori kupton si fjalor institucional të gjitha fjalët që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me institucionet politike. Aty bëjnë pjesë institucionet vetë, rolet dhe veprimet/proceset që lidhen në këtë mënyrë me to.

### **Fjalori i ideologjisë**

Gjuhës së ideologjisë i përkasin të gjitha ato fjalë që i theksojnë parimet e organizatave politike, si zgjedhje të lira/sekrete ose vendim i mazhorancës. Fjalë të këtij lloji mund të japin përshtypjen e një leksiku gjithëpërfshirës, megjithatë duhet të merret në konsideratë se ato, sipas ideologjive të ndryshme, përmbajnë edhe konotacione të ndryshme. Fjalët e fjalorit ideologjik mund të shprehin gjithashtu edhe vlera bazike të një shoqërie, si dinjitet njerëzor ose e drejta apo përgjithësimet për një ideologji të caktuar p.sh.: enverizëm, berishizëm, ristanizim, ramizëm.

### **Fjalori i përgjithshëm bashkëveprimor**

Pjesa përbërëse e fundit e leksikut politik është sipas Klein-it fjalori i përgjithshëm bashkëveprimor. Këtu mund të radhiten shembuj si viktimitë, krizë dhe çështje. Po ashtu mund të përfshihen edhe fjalët e veprimit gjuhësor si fillëzon, debaton ose negocion.

### **Figurat retorike më të pranishme në fjalimet politike**

Në debatin politik nuk merren në përdorim vetëm terma të veçantë të cilat kanë për qëllim ta nxisin lexuesin të veprojë ose mendojë në një mënyrë të dëshiruar, më shumë përdoren edhe figura të caktuara retorike për ta forcuar këtë efekt edhe më shumë. Armin Burkardt-i konsideron si mjete retorike, krahas metaforave, edhe pyetjen retorike, paralipsën, paralelizmin si dhe klimaksin, kiazmin dhe përsëritjen. Në vazhdim duam të trajtojmë këto figura retorike më hollësisht dhe të parashtrojmë edhe shembuj. Në parlament - më saktë, në një situatë dialogu parlamentar - haset shpesh forma e pyetjes retorike. Qëllim nuk është marrja e një përgjigjeje nga pleniumi, por arritja e miratimit. Për këtë, ja shembulli i autorit më sipër:

“Kush i jep SPD-së të drejtën të flasë për komplete duke qenë ju vetë ai, që la partinë e vet, kancelarin në baltë?” Komenti i synuar që askush nuk i paska dhënë SPD-së të drejtën të flasë për një komplot të këtij lloji nuk është relevant. Folësi ka më shumë për qëllim të arrijë me një pyetje retorike miratimin e pjesëmarrësve të parlamentit dhe ta përfaqësojë pikëpamjen e tij në mënyrë sa më bindëse. Figurat retorike janë njëkohësisht pyetje edhe pretendime dhe shfaqen në fjalime politike në sekuenca të tëra. Paralipsa si një formë tjetër e figurave retorike, i bën të mundur folësit ta zmadhojë vëmendjen e dëgjuesve ndaj asaj që thotë, duke mohuar shtjellimisht dhe në mënyrë paradoksale të ketë ndërmend ta thotë atë, që në fund të fundit e kumton. Për këtë, ja një citat sërish: “Rreth këtyre pyetjeve kam folur këtu në debate të mëhershme. Nuk dua ta përsëris sërish, por e them me të matur këtë fjalë personale (...)”. Siç tregojnë këto fjalë nga një debat parlamentar politikani mohon të ketë dëshirë të shprehet më tutje për këtë çështje, por e bën këtë prapë se prapë dhe arrin t’i përsërisë mendimet e tij pa qenë e mundur të ngrihet kritika se ka qenë synimi i tij direkt. Paralelizmi shfaqet në fjalimin politik kryesisht në formë anafore: “Populli ynë zgjedh deputetë, populli ynë nuk zgjedh kancelarin në ditën zgjedhore.” Po qe se kjo përsëritje “populli ynë” në fjalimin e zgjedhur shërben në përforcim të asaj që është kjo, d.m.th., një përsëritje e tillë, mund të bashkohet në një numërim në ngritje në klimaks. Në rritjen e komenteve të tij e ngre dhe drejton tendosjen e dëgjuesve kundrejt asaj që ka thënë në fund dhe e përqendron kështu vëmendjen. Po ashtu rrjedh kiazmi i radhës: “Populli nuk ekziston për partinë dhe parlamentet. Ne jemi të detyruar të ekzistojmë për popullin.” Komentet që “kryqëzohen” me njëri-tjetrin, me “popull” në fillim dhe në fund të komentit, mbështesin po ashtu shprehësinë e fjalëve. Për sa i përket figurave të përmendura, d.m.th. përsëritjet, ai kupton “shprehjen e sërishme të pikave thelbësore të një fjalie në mënyrë përmbledhëse”. Kjo mund të ndodhë nga njëra anë për të spikatur atë që është thënë, nga ana tjetër edhe për të kërkuar të drejtën e fjalës nëse zhurma ose ndërprirje në formë thirrjesh e pengojnë fjalimin.

### **BIBLIOGRAFI**

A. Ballhysa, A. Jashari, *Formim gjuhësor I*, Sejko, 2008.

A. Ballhysa, *Gjuha dhe përdorimi i saj. Çështje teorike-praktike*, Sejko, 2005.

- A. Jashari, *Vëzhgime rreth përdorimit të frazeologjisë në stilin politiko-shoqëror të gjuhës shqipe*, SF, 1990/4.
- A. Kostallari, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë, 1964.
- E. Rama, *Kurban*, Dudaj, Tiranë, 2011.
- Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë (1980, 2002, 2006).
- G. Heiko, *Gjuha dhe përdorimi i gjuhës në politikë*, Tübingen, 2002.
- Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2005, ribotim 2009.
- J. Thomaj, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1981.
- J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, SHBLU, 1991.
- J. Thomaj, *Tipat themelorë të derivacionit semantik në gjuhën shqipe*, SF, 1981/3.
- M. Gjevari, *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980.
- M. Samara, *Një vështrim i leksikut politiko-shoqëror në fjalorët shpjegues të shqipes*, SF, 1985/3.
- M. Samara, *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008.
- M. Samara, *Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe pas çlirimit*, SF, 1985/1.
- Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- W. Bergdorf, *Fjalët si armë. Gjuha si instrument i politikës*, Stuttgart, SH.B Bon, 1979.
- W. Bruggemann, *Shënime mbi gjuhën e politikës*, Dusseldorf, 1977.
- Xh. Lloshi, *Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1985/1.